28/01/2021

Shkeputur nga Letrat e Shen Joan Gojartit drejtuar shen Olimpias



“Dhe tani jam jashtezakonisht i lumtur dhe i mrekulluar te degjoj se jo vetem je cliruar nga semundja jote por se je duke mbartur te gjitha ato qe te rendojne me kaq trimeri duke e quajtur gjithcka nje “perralle te kote e boshe”. Kjo tregon vecse per nje shpirt te fuqishem e te gjalle, te pasur ne kurajo. Jo vetem te mbartim fatkeqesite tona, por t’i shohim ne sy e te kurorezohemi me cmimin e larte te durimit e duke mesuar te mos u trasmetojme te tjereve rreth nesh ndjenja shqetesimi. Dhe mos harro; ne masen qe problemet shtohen, mundesia e kurores se fitores madhohet, ne masen qe ari punohet, ne ate mase edhe pastrohet, sa me i gjate udhetimi i peshkatarit ne det, aq edhe me e madhe ajo cka ai mbledh. A e sheh bollekun qe na dhuron Perendia;Mencurine e Tij, Fuqine e Tij te pamate, Dashamiresine e Tij pambarim..Prandaj, mos u turbullo, por vazhdo te falenderosh

e lavderosh Perendine per te gjitha edhe atehere kur plot trazira e veshtiresi trokasin ne jeten tende. Edhe nese stuhite flakerojne syte e tu, mos lejo asgje te te turbulloje e frikesoje! Sepse per Perendine tone te gjitha jane te mundura, edhe ato qe frymojne ne skajet me te largeta e te erreta te shkaterrimit! Ai sjell serish ne jete ata qe mekatojne, korrigjon ata qe jane ne gabim e rivendos ne shkelqim gjerat e kalbura e te flakura tej. Nese Perendia krijon e ju dhuron jete gjerave qe nuk kishin ekzistuar mepare, askund, sa me teper mundet Ai te ndreqe ato qe tashme jane mes nesh…”

Perktheu: Angeliki Kyrousi

— facebook.com/RadioNgjallja